



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.02.2017 ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Vasilika Hysi – Zëvendëskryetare e Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 11 shkurt - 1 mars 2019;
2. Raportim periodik lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e Raportit 2018 të Komisionit Evropian, periudha 1 nëntor - 31 dhjetor 2018.

Të pranishëm:

Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike
Petrit Vasili -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim / Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Arben Ahmetaj -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Edi Paloka -	Zëvendëskryetar i Kuvendit
Fatmir Mediu -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane
Albana Vokshi -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Genc Pollo -	Kryetar i Komisionit për Integrimin Evropian

Marrin pjesë:

Mimoza Pano –	Drejtoreshë e Shërbimit të Seancës Plenare.
Dedë Kasneci –	Drejtor i Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me këtë rend dite:

Miratimi i kalendarit 3-javor i punimeve të Kuvendit për periudhën 11 shkurt- 1 mars 2019.

Çështja e dytë e rendit të ditës është raporti periodik lidhur me mirëzbatimin e planit të Kuvendit të Shqipërisë për rekomandimet e raportit të bëra në vitin 2018 nga Komisioni European, ku raportohet për masat e marra të realizuara ose jo për periudhën 1 nëntor-31 nëntor 2018. Kjo mbledhje është thirrur nga Kryetari i Kuvendit, si zakonisht, në mbarim të periudhës trijavore, meqenëse erdhi koha të miratojmë kalendarin e ri.

Besoj se të gjithë ju, të nderuar kolegë, e keni marrë kalendarin dhe jeni njohur me të në rrugë elektronike. Draftkalendarin përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancë plenare. Kështu që për këtë kalendar seancat plenare do të jenë përkatësisht në datë 14 shkurt, ditën e enjte, ora 10:00, në datën 21 shkurt, ditën e enjte, ora 10:00, dhe në datën 28 shkurt, ditën e enjte ora 10:00. Ju lutem, kush ka mendime rreth kalendarit të paraqitur mund të na i thotë. Shikoni datat e shqyrtimit nëse janë realiste.

Mimoza Pano – Në këtë kalendar që ju do të miratoni do të mbarten në kalendarin e ri të gjitha projektligjet dhe projektaktet që ka kalendarin aktual, të cilat nuk kanë përfunduar shqyrtimin në komisione. Sot nuk i kemi futur, meqenëse nuk e kemi mbyllur kalendarin aktual.

Vasilika Hysi –Faleminderit, zonja Pano!

Po, zonja Kodheli.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Hysi!

Sot është firmosur në Bruksel nga të gjitha vendet anëtare protokollin për hyrjen e Maqedonisë në Aleancë. Unë besoj se ne duhet të demonstrojmë, ashtu si në rastin e Malit të Zi... Ne jemi në të parët parlamente, midis vendeve të Aleancës, që kalojmë këtë procedurë në formën më të shpejtë të mundshme dhe ratifikojmë protokollin. Besoj se nga momenti i firmosjes qeveria të ketë gati projektligjin dhe ta sjellë në parlament. Nëse nuk gabojmë dhe mesa kuptoj nga procedura e mëparshme me Malin e Zi, kjo duhet të kalojë, minimalisht, në Komisionin e Sigurisë dhe Komisionin e Politikës së Jashtme, me qëllim që javën tjetër, pse jo në një seancë të jashtëzakonshme, të mund ta miratojmë protokollin, njëkohësisht, siç e do edhe zakoni, të mund të ftojmë ndonjë mik nga parlamenti maqedonas për t'i dhënë një ngjyrim ceremonial dhe një mirëseardhje, që ia vlen të ketë vëmendjen tonë si parlament për shumë shkaqe, që nuk është nevoja t'i parashtroj.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit, zonja Kodheli, për informacionin dhe tërheqjen e vëmendjes për ta pasur në konsideratë!

Besoj se Kuvendi i Shqipërisë, sikurse edhe më parë, do të jetë i gatshëm të ndjekë të gjitha procedurat. Ju falënderoj edhe ju për të gjithë kontributin që keni dhënë kur keni qenë ministre e Mbrojtjes!

Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili- Në pikën 9 të këtij kalendari është ende një nismë deputeti për disa ndryshime në ligjin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, të ndryshuar. I kemi bërë edhe një letër Kryetarit të Kuvendit për këtë çështje. Kjo nismë ka filluar, është lënë pezull dhe është një nismë që është lënë e kushtëzuar dhe do të rrijë pezull deri kur të vijë një ligj përkatës, sepse, po të vijë ligji përkatës, kjo nismë do të tërhiqet. Unë kërkoj që kjo nismë të hiqet nga kalendari, sepse statusi i saj është i paqartë. I është kërkuar edhe Kryetarit të Kuvendit me shkrim të zgjidhet kjo çështje, pasi nuk mund të mbahen nisma *pending* që lidhen me nisma të qeverisë. Nisma ose të merret dhe t'i shkohet deri në fund, ashtu si e kërkon Rregullorja e Kuvendit, që, nëse ka një ligj në horizont kjo nismë rrëzohet dhe i hapë rrugë ligjit, ose përfundimisht tërhiqet nga propozuesi. Të mbajmë nisma të tilla fiktive, të cilat nuk kanë fillim dhe fund, sepse kështu kanë rezultuar, nuk besoj se i shërbejnë fare këtij kalendari. Kështu që unë mendoj që kjo nismë nuk duhet të jetë fare në kalendar, sepse duhet sqaruar statusi i saj, pastaj të futet si pjesë e kalendarit ose jo.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Vasili!

Po, zonja Pano.

Mimoza Pano – Lidhur me këtë projektligj, Komisioni për Punën dhe Çështjet Sociale, si komision përgjegjës, dhe Komisioni i Ligjeve, si komision për dhënie mendimi, kanë bërë një mbledhje, ku kanë bërë prezantimin në parim të nismës nga propozuesi, deputeti Vullnet Sinaj. Në këto mbledhje ka qenë edhe përfaqësuesi i ekzekutivit dhe është thënë që po punohet për një nismë të re. Propozuesi ka dhënë dakordësinë që, nëse nisma vjen deri në fund të vitit, ne e presim nismën dhe le të bashkohen të dyja nismat, por, për sa kohë nisma nuk erdhi, ne e futëm sërish në procedurë.

Zoti Vasili i ka drejtuar letër Kryetarit lidhur me këtë çështje dhe Kryetari për këtë rast, por edhe për raste të tjera, të cilat janë drejtuar me shkresë zyrtare nga ekzekutivi, është shprehur se nismat e deputetëve nuk mund të bllokohen dhe, nëse do të ketë dy nisma të njëjta, ato do të shqyrtohen dhe do të bashkohen në komision dhe në seancë plenare. Për këtë arsye, ne komunikua edhe me propozuesin, zotin Sinaj, dhe ai ishte dakord që ta vazhdonte nismën, ta kalonte procedurën në komision dhe të miratohej. Për këtë arsye ne e kemi futur për shqyrtim në komision dhe seancë plenare.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Pano, për sqarimet!

Po, zoti Vasili.

Petrir Vasili – Zonja Pano, në qoftë se ka zhvillime të tilla dhe, kur ne ju drejtohem me shkrim, respektojmë nga ana formale komunikimin, ju mund të na njoftoni paraprakisht dhe ne nuk kemi pse t'i ngremë këto probleme këtu. Gjithmonë në rastet kur këtë komunikim e keni me shkrim. Unë si kryetar komisioni refuzoj t'i marr në konsideratë komunikimet verbale, ndërkohë që nuk ka një shprehje të qartë as nga Kryetari i Kuvendit për këtë punë. Nuk e kam fjalën vetëm për nismën, por për mënyrën e komunikimit. Nëse ka komunikim me shkrim, ju që keni komunikuar dhe keni këtë tagër duhet të merreshit vesh me ta dhe të na thoshit: "Po, përfundimisht nisma do të vazhdojë". Nëse ju do ta kishit bërë këtë komunikim, ne do të vazhdonim punën për këtë gjë dhe të mos e mbartim kot, sepse kemi shumë gjëra të mbartura dhe ne të bënim planifikimin tonë, siç komisioni e bën dhe siç e kemi diskutuar në komision kur nuk ka pasur informacione të tilla. Kështu që, mos kurseni dy gisht letër, por na thoni që këtu ku ndrin gjëja dhe ne të planifikojmë punët tona.

Mimoza Pano – Ju kërkoj ndjesë!

Komunikimi ka qenë verbal, i kam kthyer përgjigje stafit të komisionit, por nuk e kam bërë më shkresë. Ndjesë!

Vasilika Hysi- Po, zoti Ahmetaj.

Arben Ahmetaj- Unë dua, nëse e arrijmë, sigurisht, dhe nëse ia vlen kërkesa ime në bazë të procedurës, ndjesë për mosnjohjen e plotë të Rregullores, një iniciativë ligjore, që ka të bëjë me ligjin e TVSH-së.

Kohët e fundit, siç mund ta kujtoni në parlament, në ligj u bënë disa ndryshime nga deputetët, të cilët pa dashje kanë hequr një togfjalësh në momentin e fundit, ku përfshin të gjitha portalet në ngarkesë TVSH-je 20 %. Nuk ka qenë ky qëllimi. Kështu që unë kam marrë një iniciativë dhe e kam dorëzuar, për përjashtimin, duke iu referuar edhe direktivës së vitit 2018 të Bashkimit Europian, ku për median elektronike referohet ose TVSH e reduktuar, ose përjashtim. A mund të arrijmë dot ta fusim në këto tri javë?

Vasilika Hysi- Jo, nuk është e mundur, sepse edhe nisma e deputetit i nënshtrohet procedurës.

Arben Ahmetaj- Dakord.

Vasilika Hysi- Ju mund ta depozitoni në mbledhjen tjetër të Konferencës së Kryetarëve, kur të miratohet kalendari i ri dhe mund të futet.

Arben Ahmetaj- Dakord, faleminderit!

Vasilika Hysi- Faleminderit!

Të nderuar kolegë, a ka ndonjë gjë tjetër lidhur me kalendarin, a keni ndonjë sugjerim për ndonjë projektligj që mendoni se duhet shqyrtuar në komisionet që ju drejtoni? Nëse nuk keni, atëherë e mbyllim diskutimin për pikën e parë dhe ky material, ky draftkalendar i kalon seancës plenare.

Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës. Raporti periodik lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për sa u përket rekomandimeve të Komisionit Europian të bëra në raportin e vitit 2018. Periudha për të cilën raportohet është 1 nëntor-31 dhjetor 2018.

Të nderuar kolegë, besoj se e keni marrë planin e veprimit në rrugë elektronike, njëkohësisht e keni edhe përpara. A ka ndonjë koment për këtë? Ky raport është përgatitur nga shërbimet e Kuvendit, bazuar në planin e veprimit që ne kemi miratuar dhe në angazhimet e komisioneve, nënkomisioneve, por edhe të administratës së Kuvendit. Nuk e di nëse drejtori i Drejtorisë së Përafrimit, zoti Kasneci, ka diçka për të shtuar?

Dedë Kasneci- Faleminderit, zonja zëvendëskryetare!

Atëherë, te materialet që ju kemi dërguar ne kemi sqaruar që është një masë që ka mbetur e parealizuar gjatë kësaj periudhe, e cila lidhet me funksionimin e Këshillit Kombëtar për Integrimin Europian. Pra, një nga masat që parashikohet është mbledhje me shoqërinë civile për çështjet e integritetit. Kjo masë nuk është zbatuar dhe, sipas rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për Integrimin Europian, mbledhjet thirren me kërkesë të Kryetarit ose 1/3 së anëtarëve. Unë propozoj që për periudhën në vijim të mbahet në vëmendje që Këshilli Kombëtar të mblidhet dhe ta realizojë këtë masë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi- Shumë faleminderit, zoti Kasneci, për sqarimet!

Unë dua, sikurse edhe Kryetari i Kuvendit në mbledhjet e mëparshme ka tërhequr vëmendjen, t'ju kërkoja, të dashur kolegë, që të forcojmë rolin e kontrollit parlamentar dhe të përmbushim një sërë masash, të cilat në planin e veprimit lidhen me veprimtarinë e komisioneve konkrete, sidomos me Komisionin e Integritetit, me Këshillin, një sërë detyrimesh kanë edhe Komisioni i Ligjeve, Komisioni i Çështjeve Sociale dhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave. Do t'ju lutesha t'ju kushtoni vëmendje masave të realizuara dhe atyre të parealizuara, sepse periudha kohore për të cilën ne do të vlerësohemi është shumë e shkurtër, janë më pak se katër muaj para se ne të marrim një vlerësim për negociatat. Rolin e Kuvendit nuk do ta shohim vetëm te miratimi i ligjeve, por në progresraportin e fundit është thënë që duhen rezultate konkrete të kontrollit parlamentar, të forcimit të kontrollit parlamentar. Besoj se ne kemi të gjitha kapacitetet për ta bërë këtë së bashku me opozitën.

A keni ndonjë mendim, sugjerim apo plotësim lidhur me planin e veprimit dhe raportin e përgatitur? Nuk keni.

Atëherë, faleminderit!

Besoj se në ditët në vijim do të kemi kalendarët e çdo komisioni dhe nënkomisioni, sidomos të nënkomisioneve, të cilat duhet ta intensifikojnë veprimtarinë e tyre, pasi për vitin 2018 kanë rezultuar me një angazhim të paktë.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, ju e dini, e kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar, që ka një kërkesë të më shumë se 1/4-ës së të gjithë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të grupeve parlamentare të opozitës, që është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në datën 1 shkurt të vitit 2019, për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit “Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimtarisë administrative të organeve të pushtetit legjislativ, ose ekzekutiv në kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike gjatë periudhës 1 janar 2014-1 janar 2018, përfshirë çështjen, për të cilën akuzohet ish-ministri i Brendshëm, zoti Saimir Tahiri”, për ndërhyrjen e këtyre pushteteve në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organi i prokurorisë në hetimin e këtij rasti, si edhe efektet që kanë ardhur nga kjo ndërhyrje e paligjshme. Sipas ligjit për organizmin dhe funksionimin e komisioneve hetimore dhe Rregullores së Kuvendit, brenda pesë ditëve Konferenca e Kryetarëve duhet ta marrë në shqyrtim. Sot është dita dhe jemi brenda afateve ligjore për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në qoftë se keni diskutime, atëherë mund të vazhdoni.

Edmond Spaho - Sikurse ramë dakord në mbledhjen e fundit, ne po e riparaqesim kërkesën për krijimin e një komisioni të ri, jo për zgjatje afati. Objektin ju e përmendët. Në propozimin tonë janë parashtruar të gjitha arsyet dhe për këto kemi folur edhe në mbledhjen e shkuar. Objekti i punës, përbërja e komisionit dhe gjithçka tjetër, që parashikon ligji. Besoj se nesër do të kemi mundësi ta miratojmë vendimin dhe të fillojë nga puna një orë e më parë.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Spaho!

Të nderuar kolegë, nëse krahasojmë kërkesën e mëparshme me kërkesën që është ridepozituar, ka një ndryshim në objektin e veprimtarisë së komisionit hetimor, të cilit i ka mbaruar afati, sepse periudha tashmë shtrihet nga 1 janari 2014 deri në janar 2018.

Gjithashtu është parashikuar në projektvendim se komisioni administron dhe shqyrton të gjitha materialet e ardhura, në zbatim të vendimit nr. 30/2018, pa qenë e nevojshme ripërsëritja e kërkesave për informacion nga institucionet që kanë përmbushur përgjegjësitë, ku me të drejtë kolegja Felaj dha një informacion shumë të detajuar në mbledhjen e kaluar. Ka edhe një ndryshim tjetër: përbërja e këtij komisioni parashikohet të jetë me 11 anëtarë, ndërsa komisioni i mëparshëm ka qenë me 9 anëtarë.

Në mbështetje të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, Konferenca e Kryetarëve ka detyrimin që të mblidhet ta

shqyrtojë dhe në këtë detyrë e përmbushëm. Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë mendim, apo do ta kalojnë me konsensus?

Urdhëroni, zonja Felaj!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Besoj se ishim shumë të qartë në vendimin që morëm në Konferencën e kaluar të Kryetarëve, sepse qartësisht opozitës iu tha edhe nga Kryetari i Kuvendit, i cili drejtoi mbledhjen, që nuk ka pasur asnjë precedent të zgjatjes së afateve të komisionit hetimor, në momentin që afati komisioneve hetimore ka mbaruar dhe kërkesa nuk është bërë në afatin fundor, pra në kohën e duhur për zgjatjen e afatit. Ndërkohë që ka pasur precedentë të përsëritjes së kërkesave të njëjta për të lejuar, në këtë mënyrë funksionimin, komisionet hetimore. Sikundër referuat, por edhe sikundër jemi njoftuar, por edhe siç e shikojmë nga kërkesa që na është vënë sot më përpara, ka ndryshuar objekti i kërkesës, domethënë nuk është më e njëjta kërkesë nga ana e opozitës gjë që ne ia thamë opozitës dhe për të cilën ramë dakord në Konferencën e Kryetarëve. Praktikisht, i bie që duke pasur një objekt tjetër, ne kemi një kërkesë për një komision hetimor të ndryshëm nga komisioni i mëparshëm. Kështu që kërkoj për çdo rast, para se të marrim një vendim, ta rikonsideronim një kërkesë të re për të parë nëse objekti është kushtetues apo jo, sepse kjo është detyra e Kuvendit.

Në gjykimin tim është e qartë, nuk ka lidhje fare me përsëritjen e kërkesës, sepse nuk është përsëritur kërkesa *mot a mot*, por kërkesa është ndryshuar; duke u ndryshuar objekti i kërkesës, natyrisht që nuk jemi më përballë të njëjtës gjë.

Vasilika Hysi – Në fakt, është një kërkesë e re, e depozituar, ka marrë numrin e protokollit të Kuvendit nr. 454 dhe mban datën 1 shkurt 2019. Besoj se e të gjithë e keni përpara në tavolinë. Rregullorja kërkon që nëse kjo kërkesë nuk miratohet me konsensus, atëherë duhet të shprehet seanca plenare me votim.

Edmond Spaho – A është kërkesë e re? Sigurisht, është kërkesë e re, sepse kështu e lamë, që do të krijojmë një komision të ri, përndryshe pse duhet të hyjmë në lojëra të tilla, i zgjasim afatin e atij tjetrit dhe mbyllet historia. Kjo është kërkesë e re dhe as nuk e vë në diskutim. Në këtë afat kemi kërkuar edhe herën e kaluar, në qoftë se do t'i referohemi komisionit të vjetër, 1 janar 2014 dhe 1 janar 2018, asgjë nuk kemi ndryshuar nga kërkesa jonë fillestare. Për lehtësi dhe për të mos humbur kohë, po themi që ato kërkesa për materiale, të cilat u bënë gjatë punës së komisionit të parë, të jemi racional në kohë, të jenë të vlefshme, të mos fillojmë nga e para dhe të mos i hyjmë historisë që japin materiale, nuk japin materiale, jo bëj kërkesën e të tjera. Përbërja nuk më duket ndonjë çështje, që ia vlen që ta diskutojmë. Unë nuk dua të hyjmë në debatin që zhvilluam javën e kaluar, që zgjatet afati apo nuk zgjatet afati. Këtë çështje e mbyllëm. U vendos që të bëjmë një kërkesë të re, kërkesën re e kemi paraqitur

sikurse në rastin e krijimit të komisionit, që i mbylli punimet, me nder, por pa rezultat. Kështu që mendoj se duhet të kaloj në seancë plenare dhe të krijohet komisioni.

Vasilika Hysi – Urdhëroni, zonja Felaj!

Ermonela Felaj – Mua nuk më shqetëson afati i ndryshëm, nuk më shqetëson numri i ndryshëm i përbërjes së këtij komisioni hetimor, nuk është ky thelbi i gjësë. Thelbi i gjësë është se ka ndryshuar formulimi i objektit të kërkesës, çka bën fjalë për një komision hetimor të ndryshëm nga komisioni i mëparshëm. Ne ramë dakord, por ramë dakord që të përsëritnit të njëjtën kërkesë, jo të bënim lojëra fjalësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ndryshuar objekti i komisionit në formulimin e tij, dhe arsyetimin e tij, çka na vë para një gjëje të re. Natyrisht, përderisa këtë kërkesë e marrim sot, do të na duhet kohë që ta shikojmë nëse ky objekt hetimi që kërkon të ngrejë opozita, është në përputhje me Kushtetutën, apo jo. Nuk mundemi që, në mënyrë krejt formale të themi: “po, jemi dakord”, kur opozita nuk i është përmbajtur gjësë për të cilën ne ramë më herët dakord në këtë Konferencë.

Edmond Spaho – Tani të jemi seriozë njëri-tjetrit. Nëse thuhet se ka ndryshuar objekti, domethënë e ke parë materialin dhe ke konstatuar që ka ndryshuar objekti. Më thuaj, ku ka ndryshuar objekti? Nëse thua, nuk e kam parë materialin, atëherë është tjetër gjë. Mund të thuash se nuk e ke lexuar fare materialin dhe do të njihesh me të, atëherë kjo është tjetër çështje. Por të thuash se ka ndryshuar objekti dhe nuk më thua se ku ka ndryshuar objekti, kjo nuk është serioze.

Vasilika Hysi – Nga pikëpamja formale-procedurale është ajo që thotë zonja Felaj, pra kërkesa është konform ligjit, është firmosur nga 37 deputetë, i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit me shkrim, Konferenca po e shqyrton brenda e afatit, përmban çështje për të cilat do të hetohet objekti, është përcaktuar edhe përbërja e komisionit, 6 anëtarë nga maxhoranca dhe 5 anëtarë nga opozita, kryetari i komisionit, si rregull do t’u përkas nismëtarëve dhe zëvendëskryetari do t’u përkas grupimit tjetër, kërkesa përmban afatin 3-mujor. Por lidhur me thelbin e kërkesës, pa dyshim që duhet të trajtuar në përputhje me parimet bazë kushtetuese dhe jurisprudencën.

Zonja Felaj, në qoftë se ju keni gjë në lidhje me përmbajtjen e kërkesës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – Në qoftë se e ka për afatin, ky është afati që kemi kërkuar, edhe herën e kaluar, ne nuk mund të kërkojmë komision për ju. Nëse ju dëshironi të hetoni, është puna juaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zonja Hysi, kur është ngritur për herë të parë komisioni për Tahirin, në këtë komision është marrë kohë dhe në objektin e këtij komisioni ne kemi rënë dakord bashkërisht se çfarë do të hetohet në këtë çështje dhe e kemi votuar në Kuvendin e Shqipërisë. Pra, po ju rikthej në kohë se çfarë ka ndodhur me këtë komision. Tani duhet të ishte e njëjta kërkesë *mot a mot*. Ju thoni: “Nga e njihni ju, zonja Felaj këtë kërkesë”? Unë njoh kërkesën për komisionin e mëparshëm dhe kjo nuk është identike.

Edmond Spaho – Është identike dhe duhet të kemi parasysh një gjë: unë paraqes kërkesën për komision hetimor në emër të opozitës, se çfarë duam të hetojmë, është puna jonë, se çfarë doni të hetoni ju, është puna juaj, bëni kërkesa, ju garantojmë se do t’ju japim votën për ta ngritur komisionin për çfarëdolloj çështjeje, çfarëdolloj afati, por që të shkel unë ligjin dhe të bëj kërkesë në emrin tuaj, këtë nuk e bëj këtë.

Vasilika Hysi – Urdhëroni, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Mendoj se po e shpenzojmë kohën kot me këtë debat, sepse këtu nuk po gjëmë gjë tjetër, vetëm kemi përkthyer dakordësinë e dhënë nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste herën e kaluar, të gjitha këto janë verbalizuar, sepse janë rekordet e Konferencës së Kryetarëve, dhe është risjellë për të evituar debatin e shtyrjes dhe të mosshtrjes së afatit e të tjera. Megjithëse ishte influencuar nga një fenomen negativ i mosdhënies së informacionit, për të tejkaluar një debat shumë të gjatë për këtë çështje u vendos. Në rast se ka gjëra në objekt 1, 2, 3 momente, të cilat e bëjnë të papërputhshme, le të thuhet dhe të mbeten rekordet e Konferencës së Kryetarëve, në qoftë se nuk ka, le të ecim përpara. Ne nuk mund të vazhdojmë kështu çdo javë, biem një dakord një javë më parë dhe e prishim një javë më pas. E drejta për të hetuar është e pafundme për maxhorancën, po të dojë, mund të bëjë një kërkesë tjetër, ndoshta edhe më të gjerë se kaq, nuk e pengon asnjë. Kjo është një gjë, që ka përkthyer atë vullnet, për të cilin u ra dakord në Konferencën e Kryetarëve dhe ju i keni të shkruara ato që kemi rënë dakord.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Vasili!

Kush e do fjalën?

Urdhëroni, zoti Manja!

Ulsi Manja – Çështja nëse do të ngrihet komisioni hetimor apo nuk do të ngrihet, është ezauruar me kohë. Kjo ka marrë drejtimin e ka thënë Gjykata Kushtetuese, e ka thënë praktika parlamentare dhe nuk kemi pse e diskutojmë. Në mbledhjen e kaluar të Konferencës së Kryetarëve u diskutua çështja e afateve dhe u tha: “Me qëllim që mos ta shkelim Rregulloren e Kuvendit, por të ndjekim praktikën që ka ndjekur Kuvendi, po i njëjti komision hetimor, me të njëjtin objekt, të vijë në Kuvend me kërkesë të re”. Sigurisht, sot jemi me një kërkesë të re, edhe nga pikëpamja formale kërkesë e re është, sepse ky komision hetimor do të ngrihet nga

e para. Unë këtu konstatoj, me sa thotë kolegja ime, që ka ndryshim të objektit të komisionit hetimor. Kolegja ime thotë: “Është zgjeruar objekti i komisionit hetimor”. Unë, për ta ditur këtë ku, i kërkoj zonjës Hysi, si drejtuese e Konferencës së Kryetarëve, ta administrojnë vendimin e Kuvendit për ngritjen e komisionit të parë, ta shikojmë se çfarë objekti ka pasur ai komision, të njihemi, ta sjellim në variantin e objektit të komisionit që propozohet sot me kërkesën e re dhe pse jo, nga 9 anëtarë, ta bëjmë dhe me 11 anëtarë, po të doni edhe me 15. Unë kërkoj që të paktën të na jepet mundësia të njihemi me vendimin e Kuvendit që ngriti komisionin e parë, cili ka qenë objekti i komisionit të parë, që e përfundoi mandatin, siç tha zoti Spaho, me nder, por jo me sukses.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse duhet të bëjmë për këtë tjetrin.

Unë, zonja Hysi, kërkoj të na vini në dispozicion se cili ka qenë objekti i komisionit të parë, pra cili është vendimi i Kuvendit, sepse në mbledhjen e fundit kemi rënë dakord që do të përsëritet kërkesa për të njëjtin komision hetimor, me të njëjtin objekt. Thjesht ishte në mes çështja e skadimit të afatit.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Manja!

Dua t’ju sjell në vëmendje vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 30, të vitit 2018, për ngritjen e komisionit hetimor “Për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën prokuroria po heton zotin Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm”. Ky vendim është miratuar në datën 5 mars 2018.

Në këtë vendim, nëse më lejoni t’ju sjell në kujtesë:

Së pari, Kuvendi i Shqipërisë ka vendosur ngritjen e komisionit hetimor “Për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën prokuroria po heton zotin Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm”.

Së dyti, verifikohet çdolloj dyshimi për ndikim të paligjshëm në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organet kompetente të ngarkuara me ligj në hetimin penal të këtij rasti.

Së treti, hetimi synon mbrojtjen e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, shtetit të së drejtës dhe demokracisë funksionale, me qëllim parandalimin e pasojave negative për shtetin, qytetarët dhe interesin publik, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete institucionale.

Së katërti, komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi bashkë me raportin përfundimtar, i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e

përgjegjësiwe institucionale, ndryshime ose miratimesh ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e organeve përgjegjëse për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

Së pesti, komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 11 deputetë, përbërja e komisionit miratohet me vendim të Kuvendit.

Së gjashti, komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 6-mujor nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe në rastin konkret është kërkuar afati 3-mujor.

7. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

8. Ngarkohet sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij komisioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Është miratuar nga seanca plenare në datën 5 mars 2018.

Faleminderit!

Po, zoti Ahmetaj.

Arben Ahmetaj – Kisha një ndërhyrje...

Edmond Spaho – E kam kërkuar unë fjalën, zoti Ahmetaj.

Vasilika Hysi – Fjalën e ka kërkuar zoti Spaho dhe më pas ju.

Edmond Spaho – Harxhuam 10 minuta për të parë që dy projektvendimet janë një më një, përveç afatit. Projektvendimi për të krijuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Ja ku e keni projektvendimin këtu...

(Diskutime pa mikrofon)

Me cilën është ndryshe kërkesa? Me kërkesën që kam bërë unë para 1 viti, për këtë jeni duke folur?

Ermonela Felaj – Kërkesa që keni bërë ju sot është e ndryshme nga kërkesa që keni bërë para 1 viti.

Edmond Spaho – Kërkesa materializohet këtu...

Ermonela Felaj - ... ky është problemi. Ne vendosëm mbi kërkesën, pastaj vjen projektvendimi. Zgjidhim këtë të parën dhe pastaj shkojmë te vendimi...

Edmond Spaho – Më vjen keq. Në qoftë se ju...

Ermonela Felaj – Merrini dhe krahasojini, zoti Spaho, sepse ju nuk keni qenë pjesë e këtij komisioni që t'i dalloni diferencat.

Edmond Spaho – Në qoftë se doni të bëni humor..

Ermonela Felaj - ... dhe unë e kuptoj pozitën tuaj të vështirë, por që këtu ka ndryshuar, kjo është e vërtetë...

Edmond Spaho – Po pranojeni një herë dhe thuaj: po ke të drejtë, por për çdo gjë do të thoni jo, jo...

Arben Ahmetaj – Zoti Spaho, kam një sugjerim...

Edmond Spaho – Kjo punë nuk është serioze. Vendimi është një më një me përjashtim të afatit nga 1 janari 2014 më 1 janar 2018, sepse ky është objekti që unë dua të hetoj. Ju, në qoftë se doni të hetoni, siç edhe jua thashë, krijoni një komision si ta doni ju...

Vasilika Hysi – Zoti Spaho, më falni...

Edmond Spaho - ... të gjitha të tjerat i keni një më një. Nuk është 6 muaj, por është 3 muaj, kaq është...

Vasilika Hysi – Është në kompetencën e Konferencës së Kryetarëve të diskutojë 3 çështje: kërkesën, përbërjen e komisionit dhe caktimin e datës së miratimit në Kuvend.

Jemi te pika e parë për të cilën kemi një diskutim.

Po, zoti Ahmetaj.

Arben Ahmetaj – Unë sugjeroj një zgjidhje që të mos ngelemi në këtë *deadlock*. Ta marrim kërkesën edhe ne, edhe të tjerët, ta krahasojmë dhe në mbledhjen tjetër të Konferencës së Kryetarëve të vendosim nëse kërkesa është e njëjtë apo jo dhe pastaj...

(Diskutime pa mikrofon)

...gjykojmë për të tjerat. Mund të mblidhemi edhe nesër në mëngjes nuk është fare problem, vetëm na e vini në dispozicion dhe të fillojmë ta krahasojmë. Ndoshta edhe shërbimet e Kuvendit na ndihmojnë në krahasim dhe nëse është e njëjta, atëherë logjika që thotë zoti Spaho është e drejtë. Nëse është e ndryshme, atëherë ta gjykojmë prapë.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Po, zoti Vasili

Petrit Vasili – Më falni, doja t’u bëja një pyetje kolegëve. Këto materiale janë materiale që shpërndahen papritur apo i shpërndani më parë? Nëse i keni shpërndarë më parë, këto kanë qenë objekt konsultimi, në rast se nuk i kanë konsultuar atëherë i kanë munguar detyrës, në qoftë duan të fitojnë kohë është histori tjetër. Këto materiale janë në tavolinë, prandaj para se të vijmë në Konferencën e Kryetarëve secili bën krahasimet e objektit të njërit dhe me të gjitha rezervat që ka vjen në Konferencën e Kryetarëve dhe thotë: “Nuk e miratojmë këtë objekt, sepse duam që në këtë objekt kjo pikë dhe kjo pikë të hiqen”. Në rast se ne vijmë këtu vetëm për të marrë këto materiale, atëherë kjo nuk është Konferencë Kryetarësh, sepse ne nuk vendosim gjë. Këto materiale janë publike, janë në duart e secilit prej nesh. Ky krahasim

të ishte bërë për ata që kanë shqetësim për këtë çështje dhe të vinin me një vendim dhe të thoshin: Nuk jemi në gjendje ta votojmë sot, sepse 1, 2, 3 rezerva.

Por t'i kërkohet Konferencës së Kryetarëve kohë se nuk kam pasur unë kohë ta lexoj ose do ta lexoj pasi e mora në konferencë kjo nuk është në seriozitetin e kësaj konference.

Edmond Spaho – Që të jemi seriozë, të qënurit kërkesa e njëjtë e komisionit para 1 viti me këtë të sotmin materializohen në vendim. Jo më kot zonja Hysi lexoi vendimin dhe jo kërkesën, sepse vendimi është dokumenti zyrtar. Megjithatë, nëse ju thoni se kërkesa është e ndryshme nga kërkesa që kemi bërë ne para 1 viti, urdhëroni dhe më thoni ku qëndron ndryshimi. Unë po ju them se është e njëjtë, vizë më vizë siç është edhe vendimi, me përjashtim të...

Ermonela Felaj – Zoti Spaho, ne nuk kemi ardhur këtu për t'i mbushur mendjen njërit-tjetrit...

Vasilika Hysi – Zonja Felaj, ju lutem, merreni fjalën kur të mbarojë zoti Spaho!

Nuk regjistrohet kur flasin 2 persona njëkohësisht.

Ermonela Felaj – Unë e kam parë kërkesën dhe e njoh për shkak se kam qenë pjesë e atij komisioni hetimor...

Edmond Spaho – Më thuaj ku ndryshon në qoftë se e ke parë?

Ermonela Felaj - ... diferenca është e qartë...

Edmond Spaho - ... në qoftë se nuk e ke parë pastaj...

Ermonela Felaj – Këtu bëhet fjalë për të respektuar Konferencën e Kryetarëve dhe parlamentin. Natyrisht, në qoftë se kërkesa do të ishte e njëjtë *mot a mot*, ne patjetër që do t'i ishim përmbajtur vendimit për të cilin ramë dakord në konferencë tjetër, por nuk është e njëjta. Më duket me vend sugjerimi që bëri në këtë rast kolegu Ahmetaj, që Konferencën e Kryetarëve nuk e pengon asgjë...

Edmond Spaho – Ka rregulla për këtë punë, në qoftë se nuk biem dakord, kjo shkon në seancë plenare dhe pikë.

Ermonela Felaj - që të mblidhet në një moment më të shpejtë për ta konstatuar këtë gjë që jam duke ju thënë...

Edmond Spaho – Kjo shkon në seancë plenare, pastaj ju rrëzoheni me votë pastaj dhe me argumente...

Ermonela Felaj – Zoti Vasili, ne jemi njoftuar, ju lutem, a ka mundësi të dëgjoni se duke bërë zhurmë nuk dëgjoni!

Edmond Spaho – Nuk është punë zhurme..

Petrit Vasili – A i keni shpërndarë zonja Hysi?

Ermonela Felaj – Ne jemi njoftuar për konferencën të premten...

Vasilika Hysi – Do t’jua kërkoj unë shërbimeve të Kuvendit të na sqarojnë...

Petrit Vasili – Kë të sqarojnë?

Ermonela Felaj - ... dhe unë *e-mail*-in e kam përpara...

Petrit Vasili – Le ta sqarojnë shërbimet...

Ermonela Felaj – ..na është njoftuar vetëm projekt-kalendari dhe programi dhe nuk na është njoftuar kërkesa hetimore, por për mua nuk është e vështirë ta konstatoj ndryshmin, ndërsa për anëtarët e tjerë është e pamundur ta konstatojnë ndryshimin, duke mos i pasur të dyja kërkesat para.

Nuk e kuptoj pse duhet ta vini në dyshim vullnetin tonë të mirë kur ju, në fakt, e keni vënë në dyshim, duke na vendosur në këto pozita...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, po ne nuk mund të votojmë qorrazi, zoti Spaho, as formalisht, votimi duhet të ketë kuptim.

Atëherë, konstatojmë ndryshimin dhe nëse bëhet fjalë për gjëra të ndryshme do të ushtrojmë edhe ne gjitha të drejtat dhe detyrimet kushtetuese që kemi.

Vasilika Hysi – Zonja Pano, kolegët...

Petrit Vasili – Zonja Pano, a i kemi ne këto materiale?

Vasilika Hysi – ...anëtarët e Konferencës së Kryetarëve ngrenë pretendimin që në njoftimin zyrtar nuk është përcjellë kërkesa e opozitës, por është përcjellë sot pak minuta para se të fillonte mbledhja. Si qëndron puna, ju lutem!

Mimoza Pano – Po, sa i takon kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor, ne si shërbim i Kuvendit kemi marrë dijeni vetëm dje pas një telefonate të zotit Paloka. Duke qenë në kushtet e përfundimit të afatit, sepse kërkesa është depozituar te Kryetari në datën 1, në drekë, aty nuk ka pasur njeri dhe për këtë arsye nuk kemi qenë në dijeni, ndërkohë që Kryetari nuk ndodhej në Shqipëri. Pra ne jemi vënë dje në dijeni dhe në këto kushte ne i kishim dërguar materialet...

Petrit Vasili – Zonja Hysi, kjo është depozituar në datën 1? Çfarë do të thotë kjo, ishte apo nuk ishte Kryetari?

Mimoza Pano – Për të qenë në rregull me afatin e ligjit e futëm sot në Konferencën e Kryetarëve.

Petrit Vasili – Ka 1 javë dhe tani do ta lexojmë...

Vasilika Hysi – Po, zoti Ahmetaj.

Arben Ahmetaj – Për procedurë nuk kemi pse të diskutojmë politikisht. Përderisa ne e kemi marrë sot, unë nuk jam në gjendje, sepse nuk kam...

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Ju lutem, kolegë, ta diskutojmë me qetësi!

Arben Ahmetaj – Unë e kam marrë vetëm sot. Unë nuk jam jurist, por edhe të isha jurist, nuk e kam kërkesën e parë që të bëjë krahasimin. Ajo që po bëj është thjesht që po kërkoj kohë ta studioj nga ana procedurale. Ju mund të keni të drejtë, mund të jetë *mot a mot* e njëjta gjë, mund të mos jetë, kjo nuk ka fare rëndësi. Ju lutem, na vini kohë në dispozicion pasi tani e kemi marrë po ashtu edhe kërkesën e parë dhe nëse doni të mblidhemi nesër në orën 8 të mëngjesit, jam dakord, kjo nuk diskutohet.

Edmond Spaho – Sipas rregullit që unë di, ndoshta mund të jem gabim, kjo kërkesë nesër do të shkojë në seancë plenare, nëse këtu nuk do të ketë dakordësi, dhe do t'i nënshtrohet votës. Apo e kam gabim?

Vasilika Hysi – Zonja Pano.

Mimoza Pano – Sipas ligjit afati është 2 javë, brenda 2 javëve nga Konferenca e Kryetarëve, 15 ditë.

Vasilika Hysi – Unë besoj se ka një konsensus...

Petrit Vasili – Ne ramë dakord. A ramë dakord që do të paraqiteni...

Vasilika Hysi – Ju lutem, zoti Vasili, në mbledhjen e kaluar ramë dakord që komisioni do të ngrihej, por besoj se është e drejta e çdo deputeti që të njihet në kohë me materialin dhe kërkesën. Ne nuk jemi duke thënë se jemi kundër ngritjes së komisionit. Mua nuk do të më pëlqente të zbatonim Rregulloren që nuk ka konsensus dhe t'ia kalonim seancës nesër që të vendosë me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Unë pajtohem me shqetësimin që ngritën kolegët e maxhorancës dhe nuk kemi pse ta kalojmë për votim, por do të respektojmë patjetër afatin 15-ditor, për këtë do të shprehemi brenda 15 ditëve, por duhet t'u lëmë kohë kolegëve ta lexojnë dhe të mblidhemi prapë, sepse besoj që për këtë të gjithë janë të gatshëm. Në parim kemi rënë dakord që komisioni do të ngrihet, është e drejtë kushtetuese e pakicës dhe këtë nuk e vë njeri në diskutim, por nga ana tjetër është përgjegjësia e kësaj konference të analizojë dy elemente. A është përmbajtja e kërkesës në përputhje me Kushtetutën dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese? Në qoftë se ne nuk e bëjmë edhe këtë gjë, atëherë i bie...

(Diskutime pa mikrofon)

Unë mendoj zoti Spaho, nisur nga përvoja që keni, si dhe me konsensusin që është dhënë nga mbledhja e kaluar, të mos marrim vendim për të, t'u japim kohë kolegëve. Do të doja të dija sa kohë kërkojnë kolegët në dispozicion? Më pas ta kalojmë, sepse kjo duhet kaluar brenda 15 ditëve.

Faleminderit!

Edmond Spaho – Zonja Hysi, dua t'ju them dy gjëra.

Së pari, kërkesa është në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit, sepse po të mos ishte në përputhje, stafi i Kuvendit nuk do ta kishte sjellë këtu, por do ta kishte bllokuar, do të na kontaktonte ne dhe do të na thoshte: këtë nuk e keni në përputhje me këtë pikë të Rregullores, këtë tjetrën me këtë nen të Kushtetutës dhe në këtë mënyrë neve do të na duhej të bënim korrigjimet para se të vinim në Konferencën e Kryetarëve.

Në Konferencën e Kryetarëve nuk vjen çdo material, por vijnë materiale, të cilat janë në përputhje me rregullat, prandaj ky argument nuk qëndron.

Së dyti, kemi rënë dakord që do të krijohet komisioni dhe kjo histori është mbyllur dhe sipas dakordësisë nesër duhet të kalojë në seancë plenare. Unë nuk jam dakord për asnjë shtyrje tjetër dhe kohën që kërkohet për ta shqyrtuar materialin. E keni pasur mundësinë që nga 1 janari kur e kemi depozituar dhe deri më sot që është 6 janar duhej të ishte shqyrtuar me dhjetëra herë, jo një herë, dhe sot të vinin këtu me mendje të ndarë.

Unë e shikoj si një tentativë për të zvarritur punën, ashtu siç u veprua me komisionin e parë, sepse nuk u dhanë materialet nga institucionet shtetërore dhe askush nuk mban përgjegjësi për këtë. As Kuvendi, megjithëse e di se është shkelje e Kushtetutës dhe e legjislacionit për ngritjen e komisioneve hetimore. Ata që kanë penguar informacionin duhet të shkojnë për ndjekje penale, por askush nuk i dërgon. Kjo është detyra dhe përgjegjësia e Kuvendit, sepse nuk ia kanë dhënë informacionin Kuvendit, prandaj duhet t'i dërgojë për ndjekje penale, por ju nuk e bëni këtë.

Edhe këtë të sotmen e shoh në këtë prizëm, nuk doni ta ngrini komisionin, sepse ashtu siç e zvarritët radhën e parë doni të gjeni mekanizma, mundësi, shtigje për ta zvarritur edhe herën e dytë.

Vasilika Hysi – Zoti Spaho, unë isha shumë e qartë.

Së pari, shërbimet e Kuvendit e konfirmuan se me informacionin vetë shërbimet janë njohur vetëm dje, ndërsa sot u ka ardhur të gjithëve.

Së dyti, kërkesa nuk është depozituar në janar, por më 1 shkurt, që ka qenë ditë e premte. Unë kam një sugjerim për shërbimet e Kuvendit që sa herë marrin kërkesa nga grupet parlamentare qofshin maxhorancë apo opozitë të shënojnë edhe orën, sikurse e kam shënuar unë dje orën për kërkesën me interpelancë me procedurë të përshpejtuar, siç e kërkoi zoti Vasili, 13:10. Pra, mund të qëllojë që të jetë ditë e premte dhe shërbimet e Kuvendit mund të jenë larguar nga institucioni, edhe Kryetari nuk është i pranishëm, sepse është fundjavë dhe mund të ketë lëvizur, pastaj thoni se është e premte. Jo pa qëllim e përlllogarita që ishte ditë e premte.

Ne kemi pasur një kërkesë të zotit Vasili për interpelancë me ministren e Financave dhe menjëherë sapo morëm kërkesën për 20 minuta kemi vënë shënimin, kemi evidentuar orën, si dhe minutat kur i është nisur ministres, sepse kjo është korrektesë dhe nuk kemi pse të bëjmë

debate. Në kuadër të diskutimeve të Rregullores së Kuvendit, zonja Pano, ia vlen të shikojmë edhe këto elemente, të cilat mund të shërbejnë për të krijuar atë idenë që nuk ka konsensus. Ngritja e komisionit hetimor ka konsensus, por do të vlerësojmë integritetin dhe kërkesën shumë legjitime të kolegëve për të lexuar kërkesën dhe nëse ata janë të gatshëm, atëherë hajdeni të mbledhemi që nesër në Konferencën e Kryetarëve...

(Diskutime pa mikrofon)

Kolegë, kush është për ta shtyrë dhe për ta diskutuar sa më shpejt në një mbledhje tjetër të Konferencës së Kryetarëve? Kundër? 1 kundër.

Atëherë, kjo çështje kalon për t'u diskutuar. Besoj, zonja Felaj, zoti Manja, ju mjafton dita e sotme dhe e nesërme për ta lexuar dhe më pas t'ia kalojmë Kryetarit të Kuvendit për të rithirrur mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me qëllim që kjo të pasqyrohet dhe t'i kalojë seancës plenare.

Nga ana tjetër, të nderuar kolegë, kolegët e opozitës e kanë sjellë përbërjen e komisionit, prandaj i ftoj edhe kolegët e maxhorancës që të sjellin përbërjen e komisionit me qëllim që komisioni të fillojë nga puna sa më shpejt pas miratimit nga Kuvendi, nëse do të ngrihet.

Patjetër, do të ngrihet se kemi thënë që do të ngrihet. Unë kam besim te profesionalizmi i zonjës Felaj, i zotit Manja, të cilët do ta shikojnë dhe do të jenë shumë konstruktivë në diskutim.

Këtu mbyllet Konferenca e Kryetarëve, duke kaluar me konsensus draft-kalendarin e punimeve të Kuvendit për 3 javët e ardhshme, si dhe duke u kërkuar edhe një herë kryetarëve të komisioneve që të ndjekin me vëmendje planin e veprimit.

Falënderoj stafin e Kuvendit për materialet që ka përgatitur, si dhe raportin për planin e veprimit.

Faleminderit, të nderuar kolegë!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA